



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Fier, më .10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PER PROCEDUREN E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTE MONETAR

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Blerje mjete të ndryshme per nevojat e Bashkise dhe te Ndermarrjeve vartese” me 2 lote.**

Loti 1: Blerje mjete eskavator (skrepa) te rinj 3 cope dhe mjet tip fuoristrade e re 1 cope per nevojat e Bashkise Fier

Loti 2: Blerje mjete te perdorura mjet buldozer 1 cope per nevojat e Ndermarrja e Ujitjes dhe Kullimit, mjet autobot uji vadites 1 cope per nevojat e Ndermarrja e Gjelbërimit, Higjenes dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier per Bashkine Fier dhe mjet furgon per transportin e femijeve 1 cope per nevojat e Qendres “Horizont”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

“Fuoristrada” -34113300-5

“Minibus”- 34114400-3

“Automjete te renda”- 34140000-0

“Buldozere”- 43211000-5

“Makineri eskavator”- 43262000-7

VLERA E FONDIT LIMIT TË PËRBASHKËT TOTAL : Fondi limit / vlera e pritshme e përgjithëshme e kontratës: **60 503 695.66** (gjashtedhjetë milion e pesëqind e tre mijë e gjashtëqind e nentëdhjetë e pesë pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH ose **fondi limit në Euro** (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 10.10.2023): 572 788.93** (peseqind e shtatedhjetë e dy mijë e shtatedhjetë e tetëdhjetë e tete pike nentëdhjetë e tre) **Euro.**

Fondi limit total i ndarë sipas autoriteteve kontraktore përfituese:

- 1.Fondi limit i Bashkise Fier eshte ne vleren 53 737 362.33 (pesedhjete e tre milion e shtateqind e tridhjete e shtate mije e treqind e gjashtedhjete e dy presje tridhjete e tre) leke pa tvsh dhe 64 484 834.79 (gjashtedhjete e kater milion e katerqind e tetedhjete e kater mije e teteqind e tridhjete e kater presje shtatedhjete e nente) leke me tvsh .
- 2.Fondi limit i Ndërmarrjes se Gjellbërimit dhe Mirembajtjes se Varrezave Publike Fier eshte ne vleren 1 900 000 (nje milion e nenteqind mije) lekë pa TVSH dhe 2 280 000 (dy milion e dyqind e tetedhjete mije) leke me tvsh .
- 3.Fondi limit i Ndermarrjes se Ujitjes dhe Kullimit Fier eshte ne vleren 4 866 333.33 (kater milion e teteqind e gjashtedhjete e gjashte mije e treqind e tridhjete e tre presje tridhjete e tre) leke pa tvsh dhe 5 839 600 (pese milion e teteqind e tridhjete e nente mije e gjashteqind) leke me tvsh.

Loti 1: Blerje mjete eskavator (skrepa) te rinj 3 cope dhe mjet tip fuoristrade e re 1 cope per nevojat e Bashkise Fier – 51 424 029 (pesedhjete e nje milion e katerqind e njezete e kater mije e njezete e nente) lekë pa TVSH ose **fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 10.10.2023): 486 831.66 (katerqind e tetedhjete e gjashte mije e teteqind e tridhjete e nje pike gjashtedhjete e gjashte) Euro.**

Fondi limit i Bashkisë Fier eshte ne vleren prej **51 424 029 (pesedhjete e nje milion e katerqind e njezete e kater mije e njezete e nente) lekë pa TVSH.**

Loti 2: Blerje mjete te perdorura mjet buldozer 1 cope per nevojat e Ndermarrja e Ujitjes dhe Kullimit, mjet autobot uji vadites 1 cope per nevojat e Ndermarrja e Gjellbërimit, Higjenes dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier per Bashkine Fier dhe mjet furgon per transportin e femijeve 1 cope per nevojat e Qendres “Horizont” - 9 079 666.66 (nente milion e shtatedhjete e nente mije e gjashteqind e gjashtedhjete e gjashte presje gjashtedhjete e gjashte) lekë pa TVSH ose **fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 10.10.2023): 85 957.27 (tetedhjete e pese mije e neneteqind e pesedhjete e shtate pike njezet e shtate) Euro.**

Fondi limit për Lotin nr.2, i ndarë sipas autoriteteve kontraktore përfituese:

1. Fondi limit i Bashkisë Fier eshte ne vleren prej 2 313 333.33 (dy milion e treqind e trembedhjete mije e treqind e tridhjete e tre) lekë pa TVSH.
2. Fondi limit i Ndermarrjes së Ujitjes dhe Kullimit Fier eshte ne vleren prej 4 866 333.33 (kater milion e teteqind e gjashtedhjete e gjashte mije e treqind e tridhjete e tre presje tridhjete e tre) lekë pa TVSH.
3. Fondi limit i Ndërmarrjes së Gjellbërimit, Higjenes dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier, eshte 1 900 000 (nje milion e nenteqind mije) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier (organ qendror bleres) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

Loti 1: Blerje mjete eskavator (skrepa) te rinj 3 cope dhe mjet tip fuoristrade e re 1 cope per nevojat e Bashkise Fier

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2020,2021,2022), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te

regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, ne te cilin gjejme te përcaktuar se: *4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit¹.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht ne ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2020, 2021, 2022**), lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **40 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 1**). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejme te përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet*

ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: **Pika 1.** Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. **Pika 2/a:** 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **b) dyfishin e vlerës së perlllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;**

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë, perkatesisht; Pika 2/a: 2. . Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **a) dyfishin e vlerës së perlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;** Duke qene se kjo procedure prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit mbi kufirin e lartë monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **15 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 1**), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- i.** Vërtetime të lëshuara nga enti publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; **ose /dhe,**
- ii.** Faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë si dëshmi vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitetet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për mallrat (mjetet) objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, nëse është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në shqip dhe i noterizuar, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet: *”Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b. fotografitë apo katalogët teknikë.*

Duke iu referuar për analogji vendimeve të KPP-se dhe rekomandimeve të APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar që të paraqitet autorizim prodhuesi ose autorizim distributori për mallra objekt prokurimi.

Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Datë 20.03.2018 të Agjensisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore *”Rekomandim mbi hartimin e kritereve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik”*.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit **ose** fragmente të katalogut/eve të prodhuesit **ose** skede teknike të prodhuesit, që përmbajnë të dhëna dhe specifikime teknike të këtyre mallrave objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë në përputhje me karakteristikat apo specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, për mallrat objekt prokurimi. *[Nëse materiali/et të cilat do të paraqiten për të përmbushur kriterin e mesipër janë në gjuhë të huaj, ato duhet të perkthehen në shqip për pjesën e të dhënave teknike të kërkuara si dhe të noterizuara].*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet: *”Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b. fotografitë apo katalogët teknikë;”*

Paraqitja e katalogjeve është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmerisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Shënim: Operoret ekonomike të cilat do të paraqesin ofertat/ konkurrojnë për me shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si shumë së loteve për të cilat konkurrojnë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë të hartuara nga Grupi i Punës i ngritur nga zv.Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr.6179 datë 18.07.2023.

Kriteret teknike janë hartuar nga Grupi i Punës i ngritur nga zv.Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr.6179 datë 18.07.2023.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur DST ne SPE. Gjithashtu bashkelidhur gjenden dhe foto ilustruese/orientuese te mallrave objekt prokurimi.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Loti 2: Blerje mjete te perdorura mjet buldozer 1 cope per nevojat e Ndermarrja e Ujitjes dhe Kullimit, mjet autobot uji vadites 1 cope per nevojat e Ndermarrja e Gjelbërimit, Higjenes dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier per Bashkine Fier dhe mjet furgon per transportin e femijeve 1 cope per nevojat e Qendres “Horizont”.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2020, 2021, 2022**), lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **2 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 2**). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* Pika 2/a: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;**

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se

zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten sic eshte parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperme eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/a e nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur ne procedurat e prokurimit mbi kufirin e larte, perkatesisht; Pika 2/a: 2. . *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) dyfishin e vlerës se perlllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit mbi kufirin e lartë monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik .*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohe dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se **1 000 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 2**), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- i.** Vërtetime të lëshuara nga enti publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës; **ose /dhe,**
- ii.** Faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë si dëshmi vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojese se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog teknik ose fragment të katalogeve ose skede teknike për mjetin, i cili/e cila minimalisht të përmbajë një përshkrim të karakteristikave teknike dhe të dhenave të tjera në lidhje me marken, vendin e origjinës, vitin e prodhimit, etj., të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

[Nese materiali/et te cilat do te paraqiten per te permbushur kriterin e mesiperm jane ne gjuhe te huaj, ato duhet te perkthehen ne shqip per pjesen e te dhenave teknike te kerkuara si dhe te noterizuara].

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet: ”Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b. fotografitë apo katalogët teknikë;”

Paraqitja e katalogeve/skedes tenike eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise se mallrave qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST.

Shënim: Operatoret ekonomike te cilet do te paraqesin ofertat/ konkurrojnë për me shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si shumë së loteve për të cilat konkurrojnë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë të hartuara nga Grupi i Punës i ngritur nga zv.Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr.6179 datë 18.07.2023.

Kriteret teknike janë hartuar nga Grupi i Punës i ngritur nga zv.Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr.6179 datë 18.07.2023.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur DST ne SPE. Gjithashtu bashkelidhur gjenden dhe foto ilustruese/orientuese te mallrave objekt prokurimi.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e Prokurimit